

Konkurrenca dhe rimëkëmbja e qëndrueshme pas COVID-19

Përditësim ekonomik për Evropën dhe Azinë Qendrore

Zyra e kryeekonomistit

Vjeshtë 2021



PËRDITËSIM EKONOMIK I BANKËS BOTËRORE PËR EAQ-NË, VJESHTË 2021

Konkurrenca dhe rimëkëmbja e qëndrueshme pas COVID-19

Zyra e kryeekonomistit

Përmbledhje

Pas afro dy vjetësh që prej kur COVID-19-a mbërtheu së pari botën, pandemia, që ende nuk po ndalet, vazhdon të formësojë drejtimin e ekonomisë globale. Aktiviteti ekonomik në vendet e sapozhvilluara dhe në zhvillim të Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ) pritet të rritet me 5,5 për qind në vitin 2021, çka është më shumë se parashikimet fillestare, për shkak të një rimëkëmbjeje më të fuqishme sesa pritej të kërkesës së jashtme në gjysmën e parë të vitit, si edhe forcimit i kërkesës së brendshme, si rezultat i vaksinimit dhe paketave mbështetëse. Megjithatë, rritja e eksporteve po zbehet tashmë, si pasojë e përhapjes globale dhe rajonale të varianteve më ngjithëse të COVID-19-ës, që kanë dobësuar edhe rimëkëmbjen e kërkesës së brendshme. Në kontekstin global, ky përditësim përmbledh zhvillimet e fundit dhe paraqet perspektivën për rajonin. Po kështu, ai përqendrohet në konkurrencë, që është kyçe për një rimëkëmbje të fortë pas pandemisë, si edhe për rritjen e qëndrueshme afatgjatë.

Për vitin 2022, parashikohet që rimëkëmbja të shënojë një ritëm prej 3,4 për qindësh, ndërkohë që stabilizohet më tej kërkesa e jashtme dhe çmimet e artikujve, rritja globale mbetet e pandryshueshme dhe ka një tërheqje të mbështetjes me politika makroekonomike. Parashikimi mbetet tejet i pasigurt, duke patur parasysh pandeminë që vazhdon, pabarazinë në marrjen e vaksinave dhe hezitimin për t'u vaksinuar. Rimëkëmbja rajonale është shoqëruar nga një përshpejtim i menjëhershëm i inflacionit dhe mbetet e ekspozuar ndaj stresit financiar, që mund të nxitet nga një shtrëngim i beftë i kushteve të financimit të jashtëm apo një rritje e mprehtë në pasigurinë e politikave dhe tensionet gjeopolitike.

Edhe pse aktiviteti ekonomik global por ringrihet dhe prodhimi në EQA global në vitin 2021 pritet të rritet, frenimi i COVID-19-ës mbetet sfidë në rajon. Në fillim të pandemisë, përhapja e shpejtë e sëmundjes dhe kufizimi i lëvizjes e mbylljet që u vendosën për të frenuar virusin çuan në goditje të befta të ofertës dhe kërkesës, të cilat u manifestuan në rënien e prodhimit dhe produktivitetit.

Ky përditësim Ekonomik i EAQ-së analizon ndikimin e COVID-19-ës mbi firmat në rajon, duke u përqendruar te roli i konkurrencës gjatë krizës dhe rimëkëmbjes. Vëmendja është te konkurrenca, pasi ajo lidhet me dinamizmin, stimulon firmat për të ndjekur novacionin dhe motivon hyrjen dhe rritjen në treg të firmave më efikase, ndërkohë që lehtëson daljen e atyre që janë më pak të tilla. Me nisjen e rimëkëmbjes ekonomike nga kriza COVID-19, do të jetë me rëndësi të sigurohet një mjedis konkurrues biznesi, që mbështet rishpërndarjen e burimeve nga firmat më pak produktive tek ato më shumë produktive, çka nënkupton procesin e “shkatërrimit krijues”.

Pandemia COVID-19 ka shtuar shqetësimet rreth konkurrencës së kufizuar dhe pasojave të saj të mundshme mbi rritjen ekonomike. Firmat më të vogla mund ta kenë më të vështirë t'u përshtaten teknologjive ose modeleve të reja të biznesit, ka më pak gjasa të përftojë mbështetje nga qeveria dhe, si rrjedhojë, ka

më shumë mundësi të dalin nga tregu. Në këtë rast, përqendrimi dhe mbizotërimi i firmave të mëdha mund të rritet, mundësisht, duke kufizuar edhe më tej konkurrencën, pikërisht në kohën kur është më e nevojshme për të nxitur rimëkëmbjen. Treguesit e perceptuar dhe rregullatorë tregojnë se shumica e vendeve të EAQ-së mund të përmirësojnë kuadrin institucional dhe zbatimin e ligjit, për të patur një mjedis konkurrence të fortë, sidomos në Azinë Qendrore dhe Kaukazin Jugor.

Analiza përdor të dhëna nga anketa e firmave për vendet e sapozhvuilluara dhe në zhvillim në rajon tregojnë se COVID-19 pati pasoja të thella heterogjene mbi firmat. Mesatarisht, në raundin e parë të anketimit, i zhvilluar në periudhën maj-nëntor 2020, firmat në rajon raportuan një rënie me 24 për qind të shitjeve mujore dhe ulje me 10 për qind të numrit të punonjësve me kohë të plotë, krahasuar me një vit më parë. Në raundin e dytë të anketës, që u zhvillua në periudhën midis muajit nëntor 2020 dhe maj 2021, një në katër firma u përgjigjën se, për gjashtë muajt në vijim, parashikonin prapambetje në pagesat e detyruara. Firmat më të vogla e më të reja u goditën më rëndë nga kriza e COVID-19-ës. Gjatët raundit të dytë të anketës, bizneset më të vogla, më të reja dhe që drejtoheshin nga gratë ende nuk kishin parë rritje të shitjeve, që nga rënia fillestare.

Krizat mund të jenë shkatërrimtare për shumë firma, por, shpesh, kanë një mirë, pasi luajnë rol spastrues. Të dhënat e paraqitura në raport e mbështesin këtë, duke treguar se aktiviteti ekonomik në EQA, gjatë krizës COVID-19, duket se është riorientuar drejt firmave më produktive, sidomos në vendet me tregje më konkurruese. Firmat me produktivitet të lartë përpara krizës përjetuan rënie shumë më të pakta në shitje dhe numër punonjësish sesa firmat me produktivitet të ulët përpara krizës. Po kështu, firmat më produktive ishin më të prira të përshtateshin me krizën, duke rritur veprimtarinë në internet dhe punën në distancë. Sesa gjatë do të vazhdojë rishpërndarja e aktivitetit ekonomik drejt firmave më produktive varet nga fakti nëse firmat më produktive do të rriten dhe ato më pak produktive më në fund do të dalin nga tregu.

Çka është me rëndësi, në vendet me tregje më konkurruese dhe politika më të forta që mbrojnë konkurrencën, rishpërndarja drejt firmave më produktive ishte edhe më e madhe. Nga ana tjetër, në ato vende ku norma e punësimit është më e lartë në sektorin publik dhe ka një pronësi më të madhe publike të bankave, rishpërndarja nga firmat me produktivitet të ulët tek ato me produktivitet më të lartë ishte më e dobët, për shkak të konkurrencës e dinamizmit më të ulët, që lidhet me rolin më të madh të shtetit.

Së fundi, shumë qeveri në EAQ zbatuan skema me politika të gjera mbështetëse, që mundën të përballonin shpejt rënien fillestare ekonomike nga kriza e COVID-19-ës dhe ofruan lehtësim të menjëhershëm të firmave dhe punonjësve nga pasojat më të këqija. Shtrirja e mbështetjes shtetërore që e ndryshme nga vendi në vend, por, mesatarisht, gjysma e firmave raportuan se kishin marrë një lloj mbështetjeje nga qeveria, si përgjigje ndaj rënies ekonomike që solli pandemia. Në përgjithësi, mbështetja e shtetit ishte më e prirur të shkonte drejt firmave më pak produktive, firmat më të mëdha kishin më shumë të ngjarë të merrnin mbështetje në formën e shtyrjes së pagesave dhe lehtësive fiskale dhe masat

mbështetëse u vunë në dispozicion të të gjitha firmave, pavarësisht nga shkalla e novacionit të tyre përpara krizës.

Duke qenë se masat e gjera mbështetëse që u zbatuan në fillim të krizës së COVID-19-ës duket se u orientuan drejt firmave më pak efektive, pavarësisht novacionit të parakrizës, ato mund të kenë pasoja negative afatgjata për konkurrencën dhe rritjen. Ndërkohë që ekonomitë po hyjnë në fazën e ringritjes, do të ishte me rëndësi që politikëbërësit e të gjitha vendeve të nisin tërheqjen me faza të masave të mbështetjes së gjerë me politika dhe të përqendrohen te nxitja e një mjedisi konkurrues për biznesin. Një mjedis i tillë është kyç për një rimëkëmbje të fortë, rezistencën ndaj krizave të ardhshme dhe një rritje ekonomike të qëndrueshme e afatgjatë.
